

NJERËZIT LOKALË NË QENDËR TË ZHVILLIMIT TË QENDRUESHËM RURAL



Takim miqësor me banorët e Prosekut në bashkëbisedim mbi situatën aktuale në fshat.



Takim me vreshtarët e Bukmirës

ALTER zbatohet nga një konsortium rrjetesh rurale: Rjeti për Zhvillimin Rural të Serbisë; Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, në emër të Rjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD), Rrjeti për Zhvillimin Rural të BiH – Bosnja dhe Hercegovina, Rrjeti i Organizatave për Zhvillimin Rural të Kosovës, Rrjeti për Zhvillimin Rural të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rrjeti për Zhvillimin Rural në Malin e Zi, Fondacioni për Zhvillim në Turqi, Forumi Rural i Letoni-së.

Për më shumë informacion ju lutem kontaktoni:
Qendra për Zhvillim dhe Integrim (CDI)
Rigerta Loku, Menaxhere Projekti
rigertaloku@gmail.com

Në TENË (Malaj)!...

“Aty ku trualli i moçëm bart histori të mëdha, por dhe vitalitetin e banorëve të saj, ku rrasa e dheut, lind nga palca e tij e butë edhe vreshtin e rrushit autokton; edhe ftoin apo mollën, arrën, lajthinë e kumbullën e motit; por dhe hurmën, zardelinë, pjeshkë apo nektarinë e deri ullirin e bregdetit apo kivin ekzotik etj. Mjafton ta duash dhe ta punosh me fantazi dheun e të parëve të tu!



Njohja me praktikat e mira të qasjes LEADER (*Lidhje midis ekonomisë rurale dhe veprimeve të zhvillimit*) dhe GLV (*Grupi Lokal i Veprimit*) Gjeravica, në Kosovë



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Ky projekt mbështetet nga projekti ALTER–Territore Aktive Lokale për zhvillimin Ekonomik të zonave Rurale, financuar nga Bashkimi Evropian



“Animimi i zhvillimit rural në territoret lokale të bashkisë Mirditë”



Takimi shumëaktorësh mbi Animimin e Territoreve Vendore në Bashkinë e Mirditës – pikënisje për zhvillimin e qendrueshëm lokal; Humanistja Marianne Graf



Aktiviteti përmblyllës i projektit: “Mirdita Dje, Sot, dhe Nesër”



NISJA

“Animimi i zhvillimit rural në territoret lokale të bashkisë Mirditë”, mbështetet nga Komisioni Evropian nëpërmjet projektit ALTER.

- Një nismë vendore që u nis në ambientet tradicionalisht inovative të INFOKULLËS, Rubik, 22 maj 2018;
- Me synimin për të animuar territorin;
- Për të nxitur ndërveprimin mes aktorëve vendorë – Institucioneve vendore, shoqërisë civile, sipërmarrësve dhe bizneseve, fermerëve, grave, të rinjve, etj;
- Për të përfshirë gjithë komunitetin në një proces ndërtimi të besimit të ndërsjelltë;
- Për të nxitur krijimin e Grupeve Lokale të Veprimit (GLV): autoritete vendore-shoqëri civile-biznes.



Me besimin se Mirdita nesër mund të jetë një vend që ofron më tepër për banorët e saj!
Me besim në Zot, pse jo, jemi në Tokën e Katedraleve...

“Me ato që dëgjova, LEADER kërkon jo besimin në Zot, por besimin mes njeri-tjetrit...”
Imzot Dom Gjergj Meta, në takim lançues të projektit.

RRUGËTIMI

“Ky ishte misioni i projektit tonë: të krijojmë në Mirditë një Grup Lokal Veprimi, rezultat i një procesi të gjatë impenjimi dhe mirëbesimi reciprok. Kemi këndvështruar e analizuar oborrin e shtëpisë së përbashkët nga dritaret e njëri-tjetrit për një të ardhme më të mirë dhe më reale, për një kopësht më frytdhënës e një çati më të fortë” – Rigerta Loku, menaxhere e projektit

Takime të vazhdueshme me aktorët në komunitetet vendore: në Prosek, me vreshtarët e Bukmirës, në Tenë, ferma Dodaj.

“Si rrallë më parë, pjesëmarrëse në takimet ka qenë dhe Gjela Doda, nëna 103 vjecare e cila ofroi kontributin e saj në diskutime.”
Gazeta Mapo

Përfaqësues të autoriteteve vendore, shoqatave lokale dhe sipërmarrjes kanë marrë pjesë në workshopet për analizën e aktorëve dhe territorit - për të diskutuar dhe dakordësuar mbi potencialet, sfidat dhe prioritetet zhvillimore.

Aktorët vendorë kanë njohuri rreth instrumentit të politikës europiane për zhvillimin rural – qasja LEADER, falë pjesëmarrjes në trajnimin “Vlera e shtuar e kooperimit dhe partneritetit në nivel lokal – qasja Leader/CLLD”.

Vizitë studimore në GLV Gjeravica, Komunën e Decanit. Përfaqësues të tre sektorëve: publik, jopublik dhe biznesi në zonën e Mirditës morën pjesë në vizitën studimore. Ata u ekspozuan me përvojën e mirë dhe modelin pozitiv të GLV Gjeravica.

Hapa për të ardhmen:

1. Konsolidimi i bërthamës së GLV-ve dhe zgjerimi i anëtarësisë;
2. Regjistrimi ligjor i GLV Mirdita;
3. Animimi i territorit si pararendëse për hartimin e strategjisë së zhvillimit të zonës.

PËRMBYLLJA

Nisma u përmyll me sukses me eventin festiv “Mirdita Dje, Sot dhe Nesër” në qendrën kulturore “Abat Doçi” Rubik, 25 Janar 2019.

Në një atmosferë festive u dhanë dëshmi pozitive nga breza të ndryshëm për potencialet dhe mundësitë që ofron Mirdita;



“Ne i qëndrojmë një vazhdimësie: ajo që kemi sot, është, se ata që e kishin dje e kanë ruajtur me xheloz. Dhe ne nuk mund të mbyllim sytë...”
Tonin Nikolli, sipërmarrës i ri, Baven-Toven Naturae

“GLV-të – janë instrument zbatues, krahët e programit LEADER për të mbështetur zhvillimin rural dhe rigjallërimin e zonave rurale”- Rigerta Loku, menaxhere e projektit